

VLERËSIMI PARANDALUES PËR KORRUPSION I PROJEKTLIGJIT

“Për Përgjegjësitë e Zgjeruara të Subjekteve Prodhuese të Produkteve që Gjenerojnë Mbetje”

1

ÇFARË ËSHTË “VLERËSIMI PARANDALUES PËR KORRUPSION”?

Vlerësimi Parandalues për Korrupsion është një proces që:

- Analizon projektligjet për të identifikuar rreziqet potenciale të korrupsionit.
- Synon që legjislacioni të jetë transparent, i drejtë dhe i zbatueshëm pa hapësira abuzimi.
- Siguron që ligjet të mos krijojnë avantazhe të padrejta për aktorë privatë apo të çenojnë interesin publik.
- Nxiti llogaridhënie dhe transparencë në procesin ligjvënës.
- Mbështet institucionet dhe shoqërinë civile në forcimin e integritetit publik.

2

VLERËSIMI PARANDALUES PËR KORRUPSION PËRFSHIN:

- Vlerësimin e transparencës dhe konsultimit publik.
- Analizën e qëllimeve të deklaruarra dhe reale të ligjit.
- Ekzaminimin e përfitimeve publike dhe private.
- Kontrollin e përshtatshmërisë së argumentimit ligjor.
- Analizën e ndikimeve financiare.

3

KONTEKSTI

Projektligji synon krijimin e një sistemi të përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesve për produktet që gjenerojnë mbetje: një hap drejt ekonomisë qarkulluese dhe mbrojtjes së mjedisit.

Përmbledhja e opinionit mbi projektligjin

4

GJETJET KRYESORE



TRANSPARENCA DHE KONSULTIMI PUBLIK

- Konsultimi publik (25.10–07.12.2023) pati vetëm 4 komente nga 2317 shikime.
- Bashkitë nuk u konsultuan, edhe pse ligji i prek drejtpërdrejt.
- Mungesa e shqyrtimit në Këshillin Konsultativ është një mangësi procedurale.



QËLLIMET DHE MOTIVET E LIGJIT

- Ligji synon zbatimin e parimit “ndotësi paguan”, reduktimin dhe riciklimin e mbetjeve.
- Harmonizohet me Direktivën e BE për Mbetjet dhe kërkesat e Kapitullit 27.



INTERESAT PUBLIKE DHE PRIVATE

- Interesi publik: menaxhim më i mirë i mbetjeve dhe ulje kostosh për qytetarët.
- Rrezik për konflikt interesi të SHPZP-të, pasi funksionojnë si shoqëri tregtare dhe mund të synojnë fitim.
- Ka edhe mospërputhje në përkufizime midis RIA-s dhe projektligjit.



PËRSHTATSHMËRIA E NISMËS

- Nisma është e nevojshme pasi nuk ka ekzistuar më parë një ligj i posaçëm për PZP.



IMPLIKIMET FINANCIARE

- Ka rrezik që kostot të transferohen te konsumatorët dhe projektligji nuk jep një vlerësim të qartë financiar.
- Përgjashtimi i taksave ekzistuese për plastikën nuk mbështetet me të dhëna të sakta.
- Në afat të gjatë, ligji mund të ulë kostot publike dhe të nxisë riciklimin.